


# Solid Waste Management Project in Berat Region, Albania, Phase I

Funded by



Implemented by



Regional Waste Management Plan of Berat Region – Press Release

## TAKIMI I KOMITETIT DREJTUES TË PROJEKTIT TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE TË NGURTA NË QARKUN E BERATIT, FAZA I

Të Mërkurën, më 30 Tetor 2019 në sallën e mbledhjeve në Bashkinë Berat, organizohet takimi i II-të i Komitetit Drejtues të Projektit për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta në Qarkun e Beratit, Faza I.

Komiteti Drejtues përbërë nga Kryetari i Këshillit të Qarkut Berat, Kryetarët e pesë bashkive, përfaqësues nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Ambasada e Zvicrës në Tiranë, jep udhëzime strategjike dhe mbështetje për zbatimin me sukses të aktiviteteve dhe rezultateve të projektit dhe krijon transparencë e besim midis aktorëve kryesorë të interesuar.

Takimi trajton planin e zbatimit të masave afat-shkurtra për rehabilitimin e tre venddepozitimeve të mbetjeve urbane më të mëdha në Qark, planin rajonal të menaxhimit të mbetjeve për zonën e mbetjeve Berat dhe statusin e identifikimit të vendndodhjes së qendrës rajonale të menaxhimit të mbetjeve.

Bashkitë e Qarkut Berat në bashkëpunim me Këshillin e Qarkut dhe ekipin e konsulentëve po përgatisin së bashku Planin Rajonal të Menaxhimit të Mbetjeve (PRMM). Ky plan është tashmë i mundshëm në versionin draft. Për përgatitjen e dokumentit përfundimtar Banorët e Qarkut Berat janë të lutur përzemërsisht të japin komentet, vërejtjet dhe sugjerimet e shqetësimet e tyre drejtuar ekipit të projektit deri në 30 Nëntor 2019. Adresat e detajuar janë paraqitur në vijim. Projekt Planin mund të lexohet në faqet zyrtare të bashkive të Qarkut Berat, si edhe në faqen zyrtare të Këshillit të Qarkut, Berat



### SFONDI I PROJEKTIT

Bashkitë e Beratit, Kuçovës, Poliçanit, Skraparit dhe Urës Vajgurore, në Qarkun e Beratit po zbatojnë një projekt për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve (MIM) të financuar nga Sekretariati i Shtetit Zviceran për Çështjet Ekonomike SECO, të mbështetur nga INFRASTRUKTUR & UMWELT, në konsorcium me SEHLHOFF dhe FLAG.

Projekti për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta (MMN) është hartuar për t'u zbatuar sipas një qasje me dy hapa të njëpasnjëshëm: Faza I, e tanishme ofron asistencë teknike, shërbime këshilluese dhe shërbime për zhvillimin e kapaciteteve, ndërkohë që Faza II, e parashikuar në vijim do të fokusohet në realizimin e masave rajonale të investimit dhe në mbështetjen e



nevojshme institucionale për vënien në punë të masave rajonale të investimit.

## ÇFARË ËSHTË PLANI RAJONAL I MEAXHIMIT TË MBETJEVE?

Plani Rajonal i Menaxhimit të Mbetjeve (shkurt "PRMM") është projektimi për menaxhimin e mbetjeve të ngurta të gjeneruara në Qarkun Berat, duke përfshirë Bashkitë Berat, Kuçovë, Ura Vajgurore, Poliçan dhe Skrapar. Plani synon:

*"Minimizimin e efekteve negative që vijnë nga gjenerimi dhe menaxhimi i mbetjeve në shëndetin e njeriut dhe mjedisit"*

PRMM është një kërkesë themelore për financimin e investimit në një sistem të përmirësuar dhe të qëndrueshëm rajonal të menaxhimit të mbetjeve të ngurta në Qarkun Berat.

PRMM u përgatit në kuadër të Projektit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve (MIMN) i financuar nga Sekretariati Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO) me një grant prej 2.2 milion Franga Zvicerane.

## PSE PRMM DUHET TË NA SHQETËSOJË?

Qytetarët e Qarkut të Beratit kanë privilegjin të jetojnë në një zonë me trashëgimi kulturore si Kalaja e Beratit dhe me shumë bukuri natyrore: Mali



i Tomorrit, Mali i Shpiragut, Kanionet e Osumit, lugina, lumenj dhe përrenj që rrjedhin dhe pasurojnë tokën, burimi i

jetesës sonë. Sidoqoftë, mënyra e deritanishme e depozitimit të mbetjeve po e dëmton ekosistemin natyror të qarkut dhe rrezikon të ardhmen e gjeneratave të ardhshme:

- hedhja e pakontrolluar e mbetjeve ndot ajrin që thithim, tokën që na ushqen dhe ujin që është baza për të gjithë jetën
- Venddepozitimet e paligjshme dhe të pakontrolluara shkatërrojnë peisazhin dhe ekosistemet e rajonit, rrezikojnë florën dhe faunën dhe dekurajojnë aktivitetin e turizmit


PRMM na siguron ne një planifikim, për të patur:

- mjedis të pastër për një jetë të shëndetshme për fëmijët, të rriturit, kafshët dhe bimët
- mbrojtja e natyrës për të ruajtur Qarkun e Beratit si shtëpi për brezat e së nesërme
- ndërgjegjësim i rritur për çdo individ drejt një sjellje të qëndrueshme në trajtimin e mbetjeve
- Menaxhimi përmirësuar i mbetjeve si një hap drejt hyrjes së Shqipërisë në BE



# Solid Waste Management Project in Berat Region, Albania, Phase I

Funded by



Federal Department of Economic Affairs,  
Education and Research EAER  
State Secretariat for Economic Affairs SECO

Implemented by



Regional Waste Management Plan of Berat Region – Press Release


## SI DO TË ARRIHEN KËTO TARGETE?

Menaxhimi rajonal i mbetjeve do të zhvillohet në qasje të njëpasnjëshme:

- I. Përmirësimi i grumbullimit dhe largimit të sigurt të mbetjeve përfshirë rehabilitimin e venddepozitimeve kryesore bashkiake; aktivitetet e para të riciklimit (2019-2023)
- II. Zbatimi i një sistemi rajonal të menaxhimit të mbetjeve për të konsoliduar kapacitetet dhe optimizuar përdorimin e burimeve vendore të Bashkive të Qarkut Berat. Komponentët themelorë janë: landfilli sanitar rajonal; stacionet e transferimit të mbetjeve; sisteme gjithëpërfshirëse për riciklimin dhe kompostimin (2023-2028)
- III. Implementimi i objekteve rajonale të trajtimit të mbetjeve të avancuara (2028-2033)

## SI MUND TË KONTRIBUOJMË?

- Çdo qytetar – I ri apo i vjetër – luan një rol kryesor
- PRMM siguron kornizën e politikave, por ne, çdo individ, duhet të veprojmë: të REDUKTOJMË mbetjet dhe RIPËRDORIM materialet sa më shumë që të jetë e mundur.
- Është thelbësore të ndajmë mbetjet për të garantuar RECIKLIMIN & KOMPOSTIMIN - madje mund të kompostoni mbetjet tuaja organike në shtëpi për të prodhuar pleh dhe mbyllur ciklin e mbetjeve.
- Çdo hap na çon drejt një mjedisi të pastër dhe të shëndetshëm



Kontakttoni: **Projekti i Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta, Qarku Berat**  
mirela.buhuri@flag-al.org  
Tel. ++ 355 32 230 594

